

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A është gjetur Bleona Mata? Avokati sqaron përplasjen me nënën e vajzës së zhdukur - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/a-eshte-gjetur-bleona-mata-avokati-sqaron-perplasjen-me-nenen-e-vajzes-se-zhdukur/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 12:29:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 12:19:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1a4a82f9a3dbcd28f062fddb8a5c7ebc47bb25907bd891df3a80d0d90977eec8
TEKSTI	131b1413f56ee08781f27696fcbaf0f276c8bab29c50921ee6d91164ea270130
PAMJA	1d547f077a2c0e9960d1b904a1688e10b581f517f759f273d81ff079ffd94165

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	db4559b90c143fecbb2618c9766e47067a4a65956fd5e6384d2f6527ecb91980
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7a6930be9f3749f4980fd84dca137394dacb19a29045da8941f5e341c088ecc2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/db4559b90c143fecbb2618c9766e47067a4a65956fd5e6384d2f6527ecb91980>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

A është gjetur Bleona Mata? Avokati sqaron përplasjen me nënën e vajzës së zhdukur

by editor — September 26, 2026 in Aktualitet, Kronikë

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Një debat i fortë publik është rindezuar lidhur me njërin prej çështjeve më të ndjeshme të viteve të fundit në Shqipëri, atë të zhdukjes së Bleona Matës. I ftuar në emisionin "News24 Fundjavë", avokati Alban Duraj ka dhënë sqarime rreth deklaratave të tij mediatike që shkaktuan reagimin e ashpër të nënës së vajzës, Bukurie Mata.

Çështja mori vëmendje të madhe pas një daljeje televizive të avokatit Alban Duraj në një emision televiziv, ku ai deklaroi se bazuar në informacione të caktuara, mendohej se Bleona Mata ishte identifikuar në një nga vendet e Bashkimit Evropian dhe se me çështjen po merrej një detektiv privat.

Kjo deklaratë u pasua nga reagimi i nënës së vajzës, Bukurie Mata, e cila e cilësoi pohimin e avokatit si të pavërtetë, duke deklaruar publikisht se nuk e njohte atë dhe nuk i kishte dhënë asnjë informacion të tillë.

I pyetur gjatë intervistës në News24 mbi bazën e këtyre deklaratave dhe pretendimin e nënës se nuk njihen, avokati Alban Duraj sqaroi se nuk ka pasur kurrë një takim fizik apo takime personale me zonjën Bukurie Mata, por ka komunikuar me të gjatë një transmetimi televiziv.

"Unë zonjën Bukurie Mata nuk e kam takuar asnjëherë nga afër për të pirë kafe apo diskutuar privatisht. Më 25 qershor 2026 kam qenë i ftuar si ekspert ligjor në një emision. Zonja Bukurie ishte e lidhur me video-call dhe gjatë përgatitjeve para emisionit kemi komunikuar", tregoi Duraj.

Për të mbështetur pretendimin e tij se nuk ka folur pa bazë, avokati transmetoi një pjesë audio nga ai transmetim ku nëna e Bleonës e falënderonte publikisht atë dhe median për ngritjen e zërit lidhur me kërkimin e vajzës së saj.

Lidhur me pretendimet se vajza ndodhet në një vend të BE-së, Duraj u shpreh se këto informacione i referohen deklaratave të vetë nënës dhe të dhënave të grumbulluara nga një detektiv privat.

Sipas avokatit, ekziston një foto e një vajze në një shtet evropian, e cila pretendohet se ka shenjë të djegies në anën e djathtë të fytyrës, një karakteristikë e Bleonës, dhe se kjo fotografi i është dërguar detektivit privat për verifikime nëpër shkolla dhe universitete.

Në përmbyllje të intervistës, avokati Duraj deklaroi se përfshirja e tij në këtë çështje ka qenë tërësisht me qëllim human dhe publik për të ndihmuar një nënë në nevojë dhe për të sensibilizuar shoqërinë.

Ai theksoi se nëse Bukurie Mata kërkon që ai të mos prononcohet më publikisht për këtë çështje, ai do ta respektojë plotësisht dëshirën e saj. Duraj shtoi se mbetet i hapur për t'i ofruar ndihmë ligjore ose morale familjes sa herë që ajo ta shohë të arsyeshme.

TË FUNDIT

A është gjetur Bleona Mata? Avokati sqaron përplasjen me nënën e vajzës së zhdukur

SEPTEMBER 26, 2026

FOTO/ Tragjedi për familjen shqiptare, motër e vëlla mes viktimitave në Athinë

SEPTEMBER 26, 2026

10 ambasadorët e SHBA-së në Tiranë që prej vitit 1991, nga Ryerson te Yuri Kim

SEPTEMBER 26, 2026

Sulmi me kallashnikov ndaj kafenesë shqiptare në Athinë/ Dysshohet se urdhri erdhi nga burgu

SEPTEMBER 26, 2026

Kush është Bledar Çafi, "i forti" i Shkodrës që u arrestua nga SPAK

SEPTEMBER 26, 2026

Ish-këshilltari i Ramës në qendër të dosjes Hyseni/ Mediat rumune: Trajnoi kreun e SHISH

SEPTEMBER 26, 2026

Shpërthim i fuqishëm në Athinë, gjashtë persona nën rrënoja, mes tyre tre shqiptarë

SEPTEMBER 26, 2026

SPAK aksioni në Shkodër/ Në pranga Bledar Çafi, policia kërkon Indrit Doklen

SEPTEMBER 26, 2026

Tabaku: Korrupsioni është "taksa e fshehtë" që rëndon mbi familjet dhe bizneset shqiptare

SEPTEMBER 26, 2026

Kombëtarja zbrit në fushë, Tirana 'ndryshon' qarkullimin/ Ja rrugët e blokuara

SEPTEMBER 26, 2026

Previous Post

FOTO/ Tragjedi për familjen shqiptare, motër e vëlla mes viktimave në Athinë



editor

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencja dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



Erëndë në Dibër, 22-vjeçarja mbytet në lumin Drini i Zi

01

0 SHARES



Makina 150 mijë euro e Grida Dumës, dhuratë nga Ergys Agasi?! Ja çfarë thonë Lolita dhe Elvi Fundo

0 SHARES



Shkarkohet Ilir Topi/ Ish-drejtesja e CFO Pharma, Rexhina Bici pritet të drejtojë Fondin e Sigurimeve

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.